V E N D I M
Nr.73, datë 13.2.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.373, DATË 8.8.1994 "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT E STUDENTËT DHE FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS"

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.373, datë 8.8.1994, ndryshohet si vijon:

"Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitin e parë për gjithë kategoritë e shkollave është data 28 shkurt 1995. E drejta e trajtimit ekonomik lind që nga data e miratimit të bursës".

Efektet financiare që rrjedhin nga ky ndryshim, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi